



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot.
2-D/DPK	01-4954/15
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	30.12.2015



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.12.2015, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3430/15, për zyrtarin e lartë z. Shukri Luta, Këshilltar Komunal në Komunën e Kaçanikut për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur situatën e mundshme të Konfliktit të Interesit**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I.** Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3430/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Shukri Luta, Këshilltar Komunal në Komunën e Kaçanikut.

Gjatë kontrollit për identifikimin e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznese privat dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.10.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Shukri Luta, ka kontaktuar në zyratart e AKK-së, ku është njoftuar me gjendjen dhe me obligimet që ka aj si zyrtar i lartë.

Zyrtari i lartë z. Shukri Luta, Këshilltar Komunal në Komunën e Kaçanikut, është pajtuar me gjendjen por është arsyetuar se nuk ka pas njohuri lidhur me situatën e konfliktit të interesit por na ka njoftuar se në biznesin më emër N.T.P TROFTA” është bashkëpronarë por do të veproj sipas ligjit për ta parandaluar situatën e konfliktit të interesit.

z. Shukri Luta është zotuar se brenda afatit ligjor do të bej ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjit ne fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Me datën 07.12.2015, kemi pranuar dokumentet zyrtare nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Shukri Luta, nuk figuron me si person i autorizuar e as si pronar i biznesit me emër N.T.P TROFTA” numër biznesi 70770377.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Shukri Luta, Këshilltar Komunal në Komunën e Kaçanikut, duke hequr dore nga e drejta e ushtrimit të funksionit si person i autorizuar në biznes, janë krijuar rrethana të reja, andaj pas vlerësimit të gjendjes reale konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

